

Publikuar në dt. 30/06/2025

Siguro qetësinë tënde

ANSIG INSURANCE
ANNUAL REPORT 2024



Në vitin 2024 shoqëria kishte një peshë prej 6.37% në treg, në një treg me operatorë mjaft më të hershëm, me diversitet relativisht të kufizuar të produkteve dhe me një ndarje pothuaj të ngurtë të aktiviteteve ndërmjet operatorëve ekzistues, veçanërisht në produktin kryesor, sigurimin e detyrueshëm motorik.

Ansigt pozicionohet si një shoqëri që ofron të gjithë gamën e produkteve të jo jetës në treg, duke qenë e orientuar tek shërbimindaj konsumatorit dhe përmbushja e nevojave të tij me sa më pak kosto për konsumatorin, duke krijuar njëherësh një ambient profesional shërbimi dhe marrëdhënieje besimi me klientët.



Misioni i shoqërisë është ofrimi i shërbimit cilësor për individë dhe biznese për klasat e sigurimit të jo jetës, ku ajo ushtron veprimtarinë, në funksion të plotësimit të kërkesave të konsumatorëve.



Vizioni ynë është të jemi lider në çdo aspekt të standardeve në tregun e sigurimeve në Shqipëri, duke synuar një shërbim unik e cilësor ndaj konsumatorit. Konsumatorët konsiderohen partnerët tanë. Atyre u ofrohen vetëm produkte që u shërbejnë nevojave dhe objektivave të tyre.

Ansigt udhëhiqet nga ndershmëria, integriteti dhe transparencja në një treg me konkurrencë të fortë. Ndershmëria dhe konsistenca ndaj klientëve tanë konsiderohet si polica më e mirë e sigurimit që ofron shoqëria. Shoqëria gjithmonë do t'i asistojë klientët në nevojat që kanë për sigurim dhe nuk do të shesë produkte, të cilat nuk u shërbejnë atyre. Përzgjedhja me kujdes e punonjësve me përvojë e të talentuar është baza e strategjisë së shoqërisë. Trajnimet e vazhdueshme dhe nxitja për rritje profesionale e individuale janë në fokus të përhershëm.

Gjatë viteve të fundit shoqëria u përball edhe me sfida të njëpasnjëshme që krijuan pengesa për arritjen e objektivave të saj dhe vështirësuan veprimtarinë operacionale, duke mos e lejuar të ketë rritje më agresive.

Këtu mund të citohen problematikat madhore të tregut të akumuluar për më shumë se 10 vjet, si rasti i dëmeve pezull me objekt Fondin e Kompensimit nga i cili shoqëria u rëndua me pagesa të padrejta të konsiderueshme për periudha që nuk ka qenë në treg; apo ngjarje katastrofike, si përmbytjet e vitit 2017 dhe dy tërmetet e shtatorit dhe nëntorit 2019.

Duhet theksuar se lidhur me çështjeve Fondit të Kompensimit Gjykata e Lartë Ia në fuqi vendimin e gjykatës Administrative të Apelit në të cilin pranohet kërkesëpadia e Shoqërisë ANSIG SH.A për shfuqizimin e aktit administrativ të AMF lidhur me masën e kontributit për shoqërinë ANSIG për dëmet e mbetura pezull me datë aksidenti deri më 31.12.2013.

Gjithashtu kjo dekadë u shoqërua edhe me ngjarje të paprecedenta në rang global, si pandemia Covid-19, apo lufta në Ukrainë, me pasoja të ndjeshme në ekonominë botërore dhe të vendit. Kështu shoqëria ka operuar në një ambient me probleme makroekonomike të shumta dhe dy vitet e fundit, po përballat edhe me nivelin e rritur të inflacionit në vend, si dhe të kostove të financimit, e në vitet e fundit edhe me një zhvlerësim të konsiderueshëm të valutave, posaçërisht monedhës euro.

Sfida kryesore mbeten ruajtja e pozicionit aktual, si dhe zgjerimi dhe penetrimi në linjat vullnetare, për të mundësuar një rritje të qëndrueshme, në një ambient të ndryshueshëm, me kërkesë të kufizuar për shërbime sigurimi dhe me një konkurrencë të ashpër.

Gjatë 2024 inflacioni shënoi rënie të vazhdueshme dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit ka ndihmuar në rënien graduale por të vazhdueshme të presioneve inflacioniste, duke mos e cenuar perspektivën e rritjes së ekonomisë të vendit.

Norma mesatare e inflacionit vjetor zbriti në nivelin 2.1% në tremujorin e dytë të vitit, kundrejt 4.6% një vit më parë.

Tregjet dhe infrastruktura e tyre funksionuan normalisht. Veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme dhe vijoi të zgjerohej, pavarësisht efektit pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut.

Rreziqet mbetën në nivele të kontrolluara dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar vlerësohet e mirë në kushtet e përmirësimit të ndjeshëm të rezultatit financiar dhe rritjes së niveleve të kapitalizimit.

Zhvillimet ekonomike, fiskale dhe ato në tregun e punës në vend ishin pozitive, por deficitit korrent u zgjerua si pasojë e thellimit të deficitit të tregtisë së mallrave. Presionet inflacioniste kanë vijuar të bien dhe në fund të periudhës inflacioni qëndronte poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Rreziqet për zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend mbeten të pranishme. Ndaj, vlerësohet se të gjithë agjentët e ekonomisë kanë mundësinë ta shfrytëzojnë këtë periudhë të veprimtarisë për të konsoliduar bilancet e tyre financiare, për të përmirësuar kapacitetet administruese në përgjithësi dhe të rreziqeve në veçanti, si edhe për të rritur eficiencën e veprimtarisë.

Euro është zhvlerësuar në vijimësi në vitet e fundit, por viti 2024 shënoi një sjellje të zhvlerësuese të fortë. Gjatë vitit 2024 kursi i këmbimit në euro arriti deri në nivelin minimal prej 98.11.

E njëjta sjellje është evidentuar edhe në valutat e tjera. Kjo dukuri ka ndikuar në frenimin e mëtejshëm të rritjes së primeve. Në tërësi, ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar në vend kanë treguar një qëndrueshmëri të mire ndaj rreziqeve të periudhës, por sfidat mbeten të pranishme.


Shtrirja gjeografike

Shoqëria e ka shtrirë aktivitetin e saj, në të gjithë territorin e vendit, dhe operon me 10 degë, 60 zyra dhe mbi 150 pika shitjeje, me infrastrukturë të standardizuar, me 114 punonjës (31.12.2024).

114
punonjës (31.12.2024)



150
pika shitje në territor



Kapitali Ansig

Ansigt për vitin 2024 ka rritur nivelin e kapitalit, i cili është në vlerën prej **980.058.000 lekë**.

Në fund të vitit 2024 disa nga treguesit e shoqërisë arritën nivelet si më poshtë:

2.7 herë

Raporti i likuiditetit

106.3%


Treguesi i mjaftueshmerisë së kapitalit

101.3%

Raporti mbi aktivet në mbulim të provigjioneve

Niveli i kapitalit në vite:

Kapitali në milion lekë



Ansigt në tregun e sigurimeve

Ansigt tashmë prej 12 vitesh në tregun e sigurimeve, për vitin 2024 ka patur **një rritje të volumit të primeve të shkruara bruto prej 7.00 %**, krahasuar me vitin 2023. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me **93,539** milionë lekë, duke arritur shifrën **1,429,257 miliardë lekë**.

Numri i kontratave të shoqërisë është rritur me **6.72%** krahasuar me vitin 2023. Ansigt për vitin 2023 zotëronte **6.35 %**, ndërsa për vitin 2024 ka një rritje të lehtë dhe zotëron **6.37%** të tregut të sigurimit të jo jetës.

Ansigt gjatë vitit 2024 ka paguar afërsisht **601,075 milionë lekë** dëme ose **29.52%** më shume se gjatë vitit 2023. Numri i dëmeve të paguara në vitin 2024 është rritur me **257 praktika** dëmi ose me **11.59%** krahasuar me vitin 2023.

Grupi i sigurimit të mjeteve motorike: 	Sigurimi i mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta Sigurimi i mjetit me Karton Jeshil Sigurimi Kufitar i mjetit motorik Sigurimi Kasko	Grupi i sigurimit të garancive 	Sigurimi i Garancisë së Ofertës Sigurimi i Garancisë së Kontratës
Grupi i sigurimeve të pasurisë: 	Sigurimi nga Zjarri dhe rreziqet shtesë Sigurimi nga Vjedhja	Grupi i sigurimit të përgjegjësiave 	Sigurimi i Përgjegjësisë Civile për tregtuesit e naftës dhe gazit Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale Sigurimi i Përgjegjësisë Publike Sigurimi i Përgjegjësisë së Produktit Sigurimi i Përgjegjësisë së Pasagjerëve
Grupi i sigurimit të shëndetit: 	Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim Sigurimi nga Aksidentet Personale Sigurimi i Nxënësve dhe Studentëve	Grupi i sigurimit të mjeteve monetare 	Sigurimi i Parave në Kasafortë Sigurimi i Parave në Udhëtim Sigurimi i Përgjegjësisë së Bankierëve

Tregu i sigurimeve

Në vitin 2024 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej **7.03%**, krahasuar me vitin 2023.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto është rritur me **1,608,786** mijë lekë duke arritur shifrën **24,505,779** mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në **1,595,687** duke shënuar një rritje me **8.84%** krahasuar me vitin 2023.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën **22,424,827** mijë lekë duke shënuar një rritje në masën **6.66%** krahasuar me vitin 2023.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën **1,442,920** duke shënuar një rritje në masën **8.38 %** krahasuar me vitin 2023



Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 2,070,422 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 11.36 % krahasuar me vitin 2023.

Gjatë vitit 2024, janë paguar gjithsej 8,656,050 mijë lekë dëme ose 24.38% më shumë se gjatë vitit 2023.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2024 është rritur me 10,155 dhe arriti shifrën 73,482 nga të cilat 70,482 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 3,476 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

Struktura e pronësisë

Nga pikëpamja e pronësisë Ansig mbetet një shoqëri me kapital tërësisht privat, vendas. Prej vitit 2020 Ansig është në zotërim të tre aksionarëve individë, sipas strukturës në vijim:

- z. **Piro Angjeli**, zotëron **68%** të aksioneve,
- z. **Llazar Angjeli**, zotëron **22%** të aksioneve
- z. **Edlir Ruka**, zotëron **10%** të aksioneve.


Ndërkohë, dy aksionarë shërbejnë përkatësisht;

z. **Piro Angjeli** si Kryetar i Këshillit të Administrimit

z. **Edlir Ruka** si Drejtor Ekzekutiv dhe anëtar i Këshillit të Administrimit

Asambleja e Përgjithshme, e përbërë nga tre aksionarët, mbledhet rregullisht për të marrë vendimet e nevojshme në përmbushje të kërkesave ligjore dhe rregullatore, si dhe Statutit të shoqërisë.

Gjatë vitit 2024 Asambleja është mbledhur 4 herë për të marrë vendime të ndryshme sipas rendit të përcaktuar, ku përfshihen miratimet e pasqyrave financiare dhe të shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare për vitin që përfundon në 31.12.2023



Administrimi i rrezikut

Administrimi i rrezikut është një komponent i rëndësishëm për qeverisjen e shoqërisë dhe nënkupton njohjen / identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e tyre sipas shkallës së rëndësisë apo përparësisë për shoqërinë në mënyrë që të mbrohet dhe të rritet vlera e shoqërisë, fitimeve dhe kapitalit.

Administrimi i Rrezikut nënkupton që çdo punonjës në shoqëri, pavarësisht pozicionit dhe përgjegjësi që ka, është i vetëdijshëm se në punën e përditshme përballet me rreziqe, dhe të kryejë aktivitetet që janë parashikuar në manuale, rregullore ose politike për t'i administruar ato.

Gjatë 2024, DARAR në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur rrezikun e likuiditetit, rrezikun e kursit të këmbimit, shpërndarjen dhe cilësinë e aktiveve, realizimin e zërave të buxhetit, si dhe arritjen e treguesve rregullator pa anashkaluar rreziqet e tjera.

Komiteti ka në përbërje të tij 6 anëtarë, të cilët janë:

- Zëvendës drejtori Ekzekutiv Financiar
- Zëvendës drejtori Ekzekutiv Teknik
- Koordinator i Departamentin të Financës dhe Kontabilitet
- Koordinator i Departamentit të Marrjes në Sigurim
- Aktuari
- Specialisti në Departamentin e Administrimit të Rrezikut, Aktuaristikës dhe Risigurimit

Në vitin 2024 Komiteti i Administrimit të Rrezikut (AR) është mbledhur rregullisht me frekuencë 3 mujore.

Komiteti AR është një komitet operacional dhe është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve që çojnë në zbatimin e kuadrit të rrezikut në shoqëri; raportimin periodik në Këshillin e Administrimit mbi çështjet e administrimit të rrezikut, si dhe paraqitjen e propozimeve për përmirësimin e këtij kuadri. Komiteti AR ndërvepron me organet më të larta drejtuese ekzekutive të shoqërisë, përkatësisht Drejtorin Ekzekutiv dhe Këshillin e Administrimit në funksion të zbatimit me korrektësi të kuadrit të rrezikut dhe marrjes së masave të nevojshme në rastet e shmangieve, të cilat mund të vërehen dhe mund të rrezikojnë përmbushjen e objektivave.

Gjatë vitit 2024 janë kryer 4 mbledhje të Komitetit të Administrimit të Rrezikut ku janë analizuar çështje të ndryshme si:

Raporti i likuiditetit, Provat e rezistencës (stress teste), Strategjia e Investimeve dhe Administrimit të Aktiveve për vitin 2025, Raporti mbi rrezikun e kursit të këmbimit, Analiza e buxhetit dhe treguesve financiarë, arritja e treguesve rregullatorë si dhe çështje të tjera.

Gjatë 2024 inflacioni shënoi rënie të vazhdueshme dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit ka ndihmuar në rënien graduale por të vazhdueshme të presioneve inflacioniste, duke mos e cenuar perspektivën e rritjes së ekonomisë të vendit. Në muajin Dhjetor 2024, inflacioni regjistroi një nivel prej 2.1%, duke reflektuar një stabilizim të cmimeve në treg.

Tregjet dhe infrastruktura e tyre funksionuan normalisht. Veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme dhe vijoi të zgjerohej, pavarësisht efektit pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut. Rreziqet mbetën në nivele të kontrolluara dhe qëndrueshmëria e sektorit bankar vlerësohet e mirë në kushtet e përmirësimit të ndjeshëm të rezultatit financiar dhe rritjes së niveleve të kapitalizimit.

Zhvillimet ekonomike, fiskale dhe ato në tregun e punës në vend ishin pozitive, por deficitit korrent u zgjerua si pasojë e thellimit të deficitit të tregtisë së mallrave. Presionet inflacioniste kanë vijuar të bien dhe në fund të periudhës inflacioni qëndronte poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Rreziqet për zhvillimet ekonomike dhe financiare në vend mbeten të pranishme. Ndaj, vlerësohet se të gjithë agjentët e ekonomisë kanë mundësinë ta shfrytëzojnë këtë periudhë të veprimitarisë për të konsoliduar bilancet e tyre financiare, për të përmirësuar kapacitetet administruese në përgjithësi dhe të rreziqeve në veçanti, si edhe për të rritur eficiencën e veprimitarisë.

Euro është zhvlerësuar në vijimësi në vitet e fundit, por viti 2024 shënoi një sjellje të zhvlerësuese të fortë. Gjatë vitit 2024 kursi i këmbimit në euro arriti deri në nivelin minimal prej 98.11 duke regjistruar një zhvlerësim prej 5.55% krahasuar me fundvitin 2023. E njëjta sjellje është evidentuar edhe në valutat e tjera. Kjo dukuri ka ndikuar në frenimin e mëtejshëm të rritjes së primeve. Në tërësi, ekonomia shqiptare dhe sistemi financiar në vend kanë treguar një qëndrueshmëri të mire ndaj rreziqeve të periudhës, por sfidat mbeten të pranishme.

Gjithashtu, duhet evidentuar që ambienti ekonomik në vënd është përballur edhe me fenomenin e qarkullimit të lartë të punonjësve në tregun e punës për shkak të emigracionit dhe rritjes së lëvizshmërisë në tregun vendas. Kjo ka sjellë rritje të presioneve për rritje pagash si dhe vështirësi për të gjetur staf, ku më tipikët janë pozicionet e IT.

Vlerësimi i profilit të rreziqeve për kompaninë kryhet nga DARAR dhe shqyrtohet nga Komiteti AR. Ndërkohë sipas parashikimeve në manualin e Punës së Njësisë së Auditit të Brendshëm, i miratuar në shtator 2019, është përcaktuar modeli për vlerësimin e rrezikut për qëllime të auditimit të brendshëm, Ky vlerësim bëhet për çdo objekt auditimi. Në bazë të vlerësimit të rrezikut ndërtohet harta e rrezikut, si dhe kryhet planifikimi i angazhimeve të auditimit për periudhën vjetore.

Funksionet e administrimit të rrezikut ndërtohen që të jenë efektive nga pikëpamja e kostove dhe që të mundësojnë komunikimin e menjëhershëm në nivelet më të larta të drejtimit. Gjithashtu, të sigurohet një proces administrimi i integruar nga pikëpamja e roleve dhe strukturave dhe që është në harmoni me strategjinë e biznesit.

Procesi dhe struktura e sistemit të administrimit të rrezikut

Shoqëria ka hartuar dhe zbaton një kuadër të plotë për administrimin e rrezikut, si dhe ka forcuar sistemin e kontrollit të brendshëm duke e përshtatur me arritjen e objektivave të biznesit dhe rekomandimet rregullatore.

Parimet e sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë Ansig përcaktohen në dokumentat e mëposhtëm:

- Kuadri i Administrimit të Rrezikut;
- Strategjia e Investimeve dhe Administrimit të Aktiveve;
- Politika e Administrimit të Rrezikut Valutor;
- Politika e Administrimit të Rrezikut të Likuiditetit;
- Politika e Administrimit të Depozitave Bankare;
- Manuali i Risigurimit.
- Manuali i Buxhetit
- Manuali i Dëmeve
- Manuali i punës për veprime me arkën dhe paranë fizike
- Rregullore për trajtimin e dëmeve qe mbulohen nga kontratat e sigurimit të mjeteve motorike
- Manuali i Marrjes në Sigurim
- Rregullore e Ilogarive të arkëtueshme

Tërësia e dokumentave të cituar më sipër përcaktojnë politikat dhe rregullat për identifikimin dhe administrimin e rrezikut, si dhe veprimet për t'u ndërmarrë në rast ngjarjesh ekstreme. Në këtë mënyrë sigurohet harmonia e administrimit të rrezikut me strategjinë e investimeve dhe administrimit të aktiveve. Në këtë mënyrë proceset dhe struktura e sistemit të administrimit të rrezikut krijojnë një mjedis që mbështet zhvillimin e kulturës së administrimit të rrezikut në harmoni me strategjinë e shoqërisë.

Strategjia e administrimit të rrezikut përcaktohet nga lart - poshtë. Kështu, për shoqërinë ANSIG sh.a. rreziku përcaktohet në bazë të vendimeve strategjike, si dhe i orienton këto vendime. Rreziku në shoqëri konsiderohet si i qenësishëm që buron nga vetë natyra e biznesit në të cilin është e angazhuar shoqëria, por që shkakton edhe pasiguri për shoqërinë.

Ndërsa, procesi i administrimit ndërtohet nga poshtë-lart, duke përcuar kulturën e administrimit të rrezikut deri tek njësitë më të vogla operationale, të cilat konsiderohen si "pronare të rrezikut". Kështu struktura e administrimit të rrezikut është ndërtuar sipas konceptit të tre linjave të mbrojtjes. Secila nga hallkat e shoqërisë ka të përcaktuar qartë rolin e saj në administrimin e rrezikut.

Administrimi i rrezikut

Linja e parë e mbrojtjes: Këtu janë njësitë e biznesit, sipas fushave të përgjegjësive që ato kanë. Ato përbëjnë linjën e parë të vendimmarrësve në nivel operacional dhe janë përgjegjës për vendimet që marrin dhe proceset që ata operojnë, në përputhje me politikat dhe procedurat e shoqërisë.

Linja e dytë e mbrojtjes: Këtu janë funksionet mbikëqyrëse/vlerësuese e këshilluese, siç është Komiteti i Administrimit të Rrezikut dhe komitetet e tjera, pra në thelb janë funksionet e kontrollit; administrimi i rrezikut, pajtueshmëria dhe aktuaristika. Këto funksione japin këshillime për linjën e parë, e cila është përgjegjëse për vendimet operacionale. Linja e dytë monitoron grupin e rreziqeve, por nuk janë përgjegjës për administrimin e rreziqeve individuale; ata këshillojnë për metodologjitë më të përshtatshme për zbutjen ose administrimin e këtyre rreziqeve ose asistojnë në vlerësimin sasior, agregimin, raportimin dhe përshkallëzimin e rreziqeve.

Linja e tretë e mbrojtjes: Këtu përfshihen shërbimet e sigurisë e të këshillimit, konkretisht funksioni i auditit të brendshëm, me njësinë e auditimit të brendshëm që kryen shqyrtime të pavaruara dhe raporton në Komitetin e Auditimit dhe Këshillin e Administrimit. Linja e tretë e mbrojtjes nuk ka përgjegjësi për administrimin e rreziqeve apo përgjegjësi për vendimarrjen operacionale. Qëllimi është vlerësimi i pavarur dhe objektiv i procesit të biznesit për të dhënë siguri të arsyeshme mbi procesin e administrimit të rreziqeve ose rekomandime sipas rastit se si mund të përmirësohen proceset e administrimit të rrezikut. Kjo linjë përforcohet me shërbimet e auditimit të jashtëm të pavarur.

Taksonomia e rrezikut

Taksonomia e rrezikut të Ansig përbëhet nga klasat e rrezikut:

Rreziku i sigurimit

Rreziku i kreditit

Rreziku i tregut

Rreziku operacional

Rreziku i likuiditetit

Rreziku rregullator

Rreziku strategjik

Rreziku i tregut: lidhet kryesisht me lëvizje të mëdha në normat e interesit, rënie ekonomike, inflacion, apo luhatje në kurset e këmbimit valutor. Ndikimet e mundshme për shoqërinë janë rënia në shitje, ulja e fluksit të parasë apo fitimeve, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

Rreziku operacional: Lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore

Këtu do të vlerësohet dhe rreziku i metodave aktuariale të përdorura.

Kuadri i raportimit

Shoqëria është e fokusuar në drejtim të përmirësimit të vazdueshëm të sistemit të raportimit në mënyrë që të bëjë të mundur përfshirjen e të gjitha hallkave të biznesit dhe ky objektiv është realizuar me funksionimin e komiteteve si dhe me miratimin e politikave të veçanta për administrimin e rrezikut.

Si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore në vitin 2017, dhe hartimit të një kuadri të plotë të administrimit të rrezikut në periudhën 2016-2018, fokusi ka qenë tek zbatimi i kuadrit dhe konsolidimi i proceseve të kontrollit të brendshëm.

Shoqëria ka hartuar dhe miratuar politika, manuale dhe rregullore ku përcaktohen qartë detyrat e secilit punonjës, linjat e raportimit si dhe afatet.

Rreziku i sigurimit:

Kryesisht ky rrezik ndahet në dy elementë:

1. Rreziku i dizenjimit të produktit dhe vendosjes së çmimit, i cili lind nga ekspozimi ndaj humbjes financiare ku kostot dhe përgjegjësitë e marra përsipër në lidhje me një linjë produkti e tejkalojnë pritshmërinë në vendosjen e çmimit të linjës së produktit; dhe
2. Rreziku i marrjes në sigurim dhe i përgjegjësive, që është ekspozimi ndaj humbjes financiare që rezulton nga përzgjedhja dhe miratimi i rreziqeve që do të sigurohen.

Këshilli i administrimit

Anëtarët e Këshillit të Administrimit zgjidhen nga Asambleja e Aksionarëve për mandat 3-vjeçar, përcaktim që vjen nëpërputhje me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare". Gjatë vitit 2024 Këshilli është mbledhur 9 herë, për të miratuar sipas rendit rregullore, manuale pune, programet e risigurimit, për të analizuar e vlerësuar raporte të shoqërisë, veçanërisht raportet e vlerësimit të rreziqeve apo të funksionit të auditimit të brendshëm, si dhe për të analizuar veprimtarinë e saj apo për të marrë vendime të ndryshme.


Gjatë vitit 2024 mbledhjet e Këshillit të Administrimit, sipas rastit janë mbajtur me prani fizike.

Në këtë mënyrë, Këshilli i Administrimit përmbush kriterin ligjor pasi ka numër tek anëtarësh; shumica e anëtarëve janë joekzekutivë, duke siguruar pavarësinë e organit vendimmarrës. Z. Ruka mbulon edhe detyrën e Drejtorit Ekzekutiv, në cilësinë e administratorit të shoqërisë.

Më 31.12.2024 Këshilli i Administrimit i Ansig përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të miratuar nga AMF më 28.07.2023, pas emërimit nga Asambleja e Aksionarëve, për një mandat tjetër trevjeçar, si në vijim:

- 1. **Piro ANGJELI** Kryetar
- 2. **Edlir RUKA** Anëtar, ekzekutiv
- 3. **Altin PASKO** Anëtar, joekzekutiv
- 4. **Ermira SHEHI** Anëtar, joekzekutiv
- 5. **Artan BAJRAMI** Anëtar, joekzekutiv

Mandati i kryetarit dhe të gjithë anëtarëve të Këshillit përfundon më 28.07.2026.



Auditimi i brendshëm

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë Ansig, është zhvilluar duke u bazuar në :

- Ligji nr. 52 datë 22.05.2014 "Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit".
- Rregullore Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nr. 135, datë 31.10.2014 "Për procedurat dhe parimet minimale në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit".
- Rregullore e AMF-së nr. 153, datë 23.12.2014 "Për veprimtarinë e njësive të auditimit të brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit".
- Rregullore për marrëdhëniet dhe rregullimet e brendshme të Shoqërisë Ansig Sh.a. Vendimi nr.3.1 datë, 8.9.2017 e ndryshuar, vendimi nr 2.4, datë 25.05.2018, e ndryshuar.
- "Manuali i punës së Komitetit të Auditimit" nr.35/3, datë 26.02.2016, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, i ndryshuar.
- "Manual pune Njësia e Auditit të Brendshëm", nr.6.1, datë 05.09.2019, miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit, i ndryshuar me vendimin nr. 1.3, datë 12.01.2023.

Përmbledhje e aktiviteteve të Auditit të Brendshëm për vitin 2024.

Angazhimet e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2024 janë përmbushur sipas objektivave dhe objekteve të planifikuara në planin vjetor.

Programi vjetor i Njësive të Auditit të Brendshëm bazohet në universin e auditit, hartën e rrezeve, si dhe rekomandimet nga autoriteti rregullator, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Edhe në vitin 2024 programi vjetor u fokusua në:

- Auditimin e vijueshëm të përputhshmërisë në proceset e marrjes në sigurim dhe të trajtimit të dëmeve.
- Auditimin e sistemeve, regjistrimeve kontabël dhe raportimeve financiare.
- Auditimin e proceseve, si trajtimin e dëmeve, shitjen, marrjen në sigurim.
- Auditimin e befasishëm në kuadër të dhënies së sigurisë për integritetin e vlerave monetare dhe të ngjashmeve me të.



Në vitin 2024 u planifikuan dhe u realizuan angazhimet e auditimit si më poshtë:

- I - auditime të befasishme: u realizuan 100%.
- II - auditime të dedikuara për zbatimin e rekomandimeve: u realizuar 100%.
- III - auditime të proceseve të punës: të realizuar 104% si rrjedhojë e paraqitjes së nevojës për të kryer auditime të paplanifikuara me kërkesë të drejtimit.
- IV – auditime të vijueshme: realizuar 100%.
- V – auditime rishikimi: 2 auditime të paplanifikuara realizuar 100%.

Në total, angazhimet e auditimit janë përmbushur në masën 100.8%

Nga angazhimet e auditimit të kryera u dhanë gjithsej 32 rekomandime. Auditimi i brendshëm ka raportuar rregullisht në Komitetin e Auditimit dhe në Këshillin e Administrimit mbi gjetjet dhe rekomandimet.

Performanca dhe sfidat e 2024



Nga sfidat drejt konsolidimit dhe inovacionit.

Shoqëria Ansig sha që hyri në tregun e sigurimeve rreth 12 vjet më parë, është përballur për pasojë me një treg relativisht të ngurtësuar, me klientelë me edukim të pamjaftueshëm në konsumin e produkteve të sigurimeve, si dhe me fenomenin e detyrimeve të pagesave të prapambetura me objekt fondi i kompensimit, në shuma të konsiderueshme. Këto detyrime të bartura për më shumë se një dekadë përpara se shoqëria të hynte në treg iu ngarkuar padrejtësisht edhe Ansig, gjë që detyroi nisjen e procedurave administrative dhe ligjore në gjykatë për të rivendosur të drejtën e Ansig për të mos u ngarkuar me detyrime që nuk i takonin. Pas më shumë se një dekade procedurash gjyqësore, Ansig rivendosi këtë të drejtë nga pikëpamja ligjore dhe është në procedura të korrektimit të detyrimeve dhe pagesave të pamerituara të kryera nga viti 2014 e në vijim. E gjithë kjo situatë e deformuar prej 10 vitesh ka ndikuar jo pozitivisht edhe në treguesit financiarë të shoqërisë, e mbi të gjitha në ndjekjen e objektivave fillestarë strategjikë të biznesit.

Për këtë arsye shoqëria mbetet e orientuar në ruajtjen e pozicionit të saj në treg me synime më modeste drejt ndryshimit modelit të portofolit të produkteve. Për rrjedhojë, pesha kryesore në portofolin e produkteve, e matur me primet e shkruara bruto, mbetet sigurimi motorik.

Sa i përket sigurimeve vullnetare, ku dhe aty shfaqet ngurtësimi i tregut në produktin e sigurimit të pronës për efekt kredie, shoqëria po synon ofrimin e produkteve novatore për klientë të vegjël dhe shumë të vegjël.

Si rrjedhojë e kombinimit të faktorëve afatgjatë dhe më afatshkurtër, në vitin 2024 shoqëria vijoi tendencën rritëse, me fokus në shitjen e produkteve të sigurimit të detyrueshëm.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për këtë vit arritën në vlerën rreth 1.25 miliardë lekë ose 7% më shumë se në vitin 2023 (një vit më parë rritja vjetor ishte 5.2%). Numri i kontratave të sigurimit arriti në 107 mijë ose rreth 6.7% më shumë se një vit më parë, duke zgjeruar më tej bazën e klientelës.

Po ashtu janë rritur pagesat e e dëmeve me 29.52% krahasuar me vitin 2023m në përafërsisht 0.6 miliardë lekë. Numri i praktikave të dëmeve të paguara për vitin 2024 është 2,475 ose 11.6% më shumë praktika dëmi të paguara, krahasuar me vitin 2023, pjesa më e madhe e të cilave natyrisht i përket sigurimit motorik.

Sfidat e pranishme në dy vitet e fundit mbetën të theksuara edhe gjatë vitit 2024. Nëse ka një ecuri lehtësuese në aspektin e inflacionit apo normave të interesit, viti i kaluar vijoi me një nënçmim të monedhës së euros, monedhë në të cilën kryhet një pjesë e aktivitetit në tregun e sigurimeve. Më tej, emigrimi vijoi të godasë si kërkesën për produkte sigurimi, ashtu edhe ofertën në tregun e punës dhe koston e punonjësve. Në këtë aspekt, shoqëria ka nisur dhe është në proces të adoptimit të strukturave më fleksibël dhe të krijimit të ekipeve të kombinuara me punonjës me kohë të plotë dhe ekspertizë nga jashtë saj. Në objektivin e saj afatmesëm tashmë është formësuar nevoja për ristrukturim organizativ.

Po ashtu, në përputhje me planin e saj afatmesëm kompania do të vijojë të fokusohet në segmentin e sigurimit për individë duke ofruar edhe produkte novatore.


A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Edlir Ruka'.

Edlir RUKA
Drejtor Ekzekutiv

Ecuria 2024

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për vitin 2024 arritën vlerën prej **1.429 miliardë lekë** ose **7%** më shumë se në vitin 2023. Nga këto të ardhura, rreth **1,248 milionë lekë** janë gjeneruar nga sigurimi i detyrueshëm dhe **181 milionë lekë** nga sigurimi vullnetar.

Shoqëria vijon të jetë e fokusuar në shitjen e produkteve të sigurimit të detyrueshëm. Numri i kontratave të sigurimit, të lidhura për vitin 2024, arriti në shifrën **107 mijë** ose me një rritje **6.72%** krahasuar vitin 2023




Sigurimi Motorik

Ansizg zotëron **7.90 %** të tregut të sigurimit të jo jetës për sigurimet motorike. Pesha në treg e shoqërisë për këtë portofol ka rënë afërsisht me 1.25% krahasuar me vitin 2023.

Primet e sigurimit motorik, gjatë vitit 2024 arritën rreth 1,329 milionë lekë ose 7.41% më shumë se viti 2023. Në volumin e primeve që vijnë nga sigurimet motorike përfshihen sigurimi MTPL e brendshme; Sigurimi Kufitar; Sigurimi Kartonit Jeshil dhe sigurimi Kasko.

Për vitin 2024, peshën specifike më të madhe e zë produkti i MTPL së brendshme me 81.1% ndaj totalit të grupit motorik. Megjithatë, prirja është që përqendrimi në këtë produkt të ulët relativisht në favor të llojeve të tjera të sigurimit në këtë grup.



Ecuria 2024


Ansiz zotëron **8.3%** të tregut të sigurimit të jo jetës për sigurimet e detyrueshme motorike. Pesha në treg e shoqërisë është rritur me **7.83%** në krahasim me vitin 2023.

Sigurimi detyrueshëm motorik, që përfshin sigurimin MTPL e brendshme, sigurim Kufitar dhe atë të Kartonit Jeshil, solli një nivel primesh të shkruara bruto në vlerën **1,248 milionë lekë** për vitin 2024 ose **8.3%** të totalit. Krahasuar me vitin 2023 primet e shkruara bruto të ardhura nga sigurimi i detyrueshëm u rriten me **90,648 milionë lekë** ose me **7.83%**.

Produkti MTPL e brendshme, për të njëjtën periudhë, pati një rritje rreth **9.31%** të volumit të primeve të shkruara bruto. Primet e shkruara bruto për këtë produkt arritën vlerën prej **1,078 milionë lekë**. Ansiz zotëron **8.50%** të tregut të sigurimeve të jo jetës për këtë produkt për vitin 2024.

Produkti Sigurim Kufitar gjatë vitit 2024 pati një rënie të volumit të primeve të shkruara bruto me **9.1%** të tregut për këtë produkt. Primet e shkruara bruto arritën shifrën prej **43 milionë lekë**. Ansiz për vitin 2023 zotëron **8.5%** të tregut të sigurimeve të jo jetës për këtë produkt.

Produkti Karton Jeshil, për të njëjtën periudhë arriti një volum të primeve të shkruara bruto prej **126.7 milionë lekë**, me një rritje prej **2.59 %** dhe me një peshë specifike në tregun e sigurimeve të jo jetës prej **6.78%**.





Siguro Qetësinë tënde

Sigurimi nga Zjarri dhe rreziqet shtesë i ofrohet çdo personi që paraqet kërkesën për të siguruar pasurinë e paluatjshme, ndërtesat dhe/apo pjesë të tjera të njësisë. Ky sigurim mbulon humbjen, dëmtimin dhe/apo shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe/apo aksidentale. Këtij sigurimi mund ti shtohen edhe mbulimi nga rreziqe shtesë si:

- **tërmeti**
- **permbytja etj..**

Ecuria 2024

Ansiz zotëron 2.5 % të tregut të sigurimit të jo jetës për sigurimet vullnetare.

Sigurimi vullnetar, që përfshin sigurimin zjarri dhe forcat e natyrës dhe dëmtimet e tjera në pronë, sigurimin kasko, sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, sigurimin e garancive, si dhe sigurimet e përgjegjësiave civile, marinë, aviacion dhe transport, solli një nivel primesh të shkruara bruto në vlerën 181.6 milionë lekë ose 12.7% të totalit. Krahasuar me vitin 2023 primet e shkruara bruto të ardhura nga sigurimi vullnetar u rriten 2,890 milion lekë.

Për vitin 2024, peshën specifike më të madhe brenda grupit të sigurimeve vullnetare e zë produkti Kasko, me 44.86% ndaj totalit të grupit.


Produkti Kasko, gjatë vitit 2024 pati një rritje të lehtë prej 1.02 % të volumit të primeve të shkruara bruto. Primet e shkruara bruto arritën shifrën prej 81.5 milionë lekë, me një peshë prej 4.62% ndaj totalit të tregut të sigurimeve të jo jetës.

Në portofolin sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës dhe dëmtimet e tjera në pronë, gjatë vitit 2024 vihet re një rënie e volumit të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli, krahasuar me vitin 2023 perkatesisht me 2.28% Volumi i primeve të shkruara bruto për këtë portofol është 33.5 milionë lekë, me një peshë prej 1.28% ndaj totalit të tregut të sigurimeve të jo jetës.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, gjatë vitit 2024, patën një rënie me 31.11% krahasuar me vitin 2023. Volumi i primeve të shkruara bruto për vitin 2024 arriti në rreth 3.2 milionë lekë, me një peshë prej 0.23% ndaj totalit të tregut të sigurimeve të jo jetës.


Në portofolin e sigurimit të garancive, u arrit një volum primesh të shkruara bruto prej 16.2 milionë leke, me një rritje prej 22.80 % dhe me një peshë prej 4.49% ndaj totalit të tregut të sigurimeve të jo jetës.

Për sigurimet e përgjegjësiave civile, marinë, aviacion dhe transport, kemi një rritje të volumit të primeve të shkruara bruto për vitin 2024, me 1.1 % krahasuar me vitin 2023. Volumi i primeve të shkruara bruto për këto sigurime, për vitin 2024 është 43.6 milionë lekë.



Ecuria 2024


Pagesat e dëmeve gjatë vitit 2024 u rriten me **29.52 %** krahasuar me vitin 2023. Dëmet e paguara për vitin 2024, arritën afërsisht **601 milionë lekë** ose rreth **137 milionë lekë** më shumë, krahasuar me vitin 2023. Numri i praktikave të dëmeve të paguara për vitin 2024 është **2,475** ose **11.6%** më shumë praktika dëmi të paguara, krahasuar me vitin 2023. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara i përket sigurimit motorik, **84.02 %** të totalit të dëmeve të paguara.



Dëmet e paguara për sigurimin motorik, për vitin 2024 arritën vlerën prej 505 milionë lekë ose 84.02 % mbi totalin e dëmeve të paguara. Brenda portofolit të sigurimeve motorike peshën më të madhe e zë MTPL e brendshme, me 81.2 % ndaj totalit të portofolit.

Ndërsa pjesa i përket dëmeve të paguara për sigurimin e detyrueshëm motorik, për vitin 2024 arritën vlerën rreth 435.2 milionë lekë, ose 72.4 % mbi totalin e dëmeve të paguara.

Brenda portofolit të sigurimeve të detyrueshme motorike peshën më të madhe e zë MTPL e brendshme, me 94.2% ndaj totalit të portofolit.



Objektivat

Sfidat kryesore për shoqërinë mbeten **ruajtja e pozicionit aktual**, si dhe **zgjerimi dhe penetrimi në linjat vullnetare**, për të mundësuar një rritje të qëndrueshme, në një ambient të ndryshueshëm, me kërkesë të kufizuar për shërbime sigurimi dhe me një konkurrencë të ashpër, e vështirësuar edhe më tej nga situata aktuale post-pandemike dhe inflacioni i lartë.

Në kushtet kur po vijon mbizotërimi i një ambienti pasigurie, objektivat për vitin 2025, të përcaktuara në planin e biznesit trevjeçar, fokusohen në:

- Ruajtjen e pozicionit në treg të shoqërisë, prej rreth **7%**;
- Administrimin e kostove si pasojë e inflacionit;
- Mbajtjen e punonjësve dhe kombinimi efektiv me shërbime mbështetëse;
- Mbajtjen e qëndrueshme të bazës së klientëve;



Shoqëria do të vijojë të ndjekë një politikë të kujdesshme të administrimit të kapitalit, për të mbështetur rritjen e saj, duke respektuar treguesit rregullatorë.

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Aksioneret e Ansig sh.a.

Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ansig sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të përshkruara në seksionin e raportit tonë *Baza për Opinionin me Rezervë*, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare.

Baza për opinionin me rezervë

1. Sikurse është paraqitur në shënimin 16 dhe 39 të pasqyrave financiare bashkëlidhur, në zërin fondi i kompesimit përfshihet vlera prej 40,000 mijë lekë e përlogaritur nga Shoqëria si e drejtë për mbipagesat e fondit të kompesimit. Duke u mbështetur në Vendimin Nr. 00-2024-2376 Datë 04.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Shoqëria ka vlerësuar si të rikuperueshme, përgjatë një perludhë 3 vjecare, shumën prej 114,517 mijë lek të drejtave mbi bazën shpenzimeve të mbipaguara për fondin e kompesimit. Edhe pse gjatë vitit 2025, në vendimet e fundit të Komisionit të Dëmeve pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Shoqërisë nuk i janë ngarkuar detyrime për fondin e kompensimit, ne nuk mund të merrnin sigurinë e arsyeshme dhe të duhur për saktësinë dhe plotësinë e vlerës së njohur në të drejta dhe të ardhura të tjera për fondin e kompesimit.
2. Sikurse është paraqitur në ankesat suplementare, Shoqëria ka llogaritur nivelin e aftësisë paguese në vlerën 393,308 mijë lekë (2023: 412,198 mijë lekë), dhe aktive në mbulim të provigjoneve teknike prej 101.31% (2023: 92.70%) të nivelit të normave të kërkuara nga ligji dhe aktet rregulluese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Për shkak të efekteve të çështjes të përshkruar në paragrafin e e mësipërm ne nuk mund të përcaktojmë nëse rregullime në raportin e aftësisë paguese në vlerën dhe aktive në mbulim të provigjoneve teknike do të ishin të nevojshme.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.



- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi. Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin numër 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2024 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.


Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të Aftësisë Paguese dhe Aktivitetit për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 28-prill 2025



Ansig sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivët afatgjatë			
Aktivë afatgjatë materiale	8	33,664,017	34,303,013
Aktivë afatgjatë jo-materiale	9	31,527,974	33,195,017
Investime në toka dhe ndërtesa	10	227,512,387	378,595,332
E drejta e përdorimit të asetëve	11	27,964,713	43,009,255
Depozita me afat	18	55,000,000	55,000,000
Investime në obligacione	12	39,260,000	41,552,000
Totali Aktivëve Afatgjatë		414,929,091	585,654,617
Aktivët Afatshkurtra			
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	13	250,601,568	257,067,071
Aktivë nga risigurimi	14	72,565,875	87,234,591
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	15	210,866,245	157,491,585
Parapagim i tatimit mbi fitimin		828,947	-
Aktivë të tjera	16	66,404,374	8,637,475
Bono thesari	17	-	46,200,000
Depozita me afat	18	697,470,211	576,777,966
Mjete monetare dhe ekuivalente	19	18,560,779	17,273,127
Totali Aktivëve Afatshkurtra		1,317,297,999	1,150,681,815
TOTALI AKTIVEVE		1,732,227,090	1,736,336,432
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	980,058,000	874,305,000
Rezerva e rivlerësimit		-	30,215,000
Rezerva e rrezikut të sigurimit	21	18,151	18,151
Humbje të mbartura		(418,327,563)	(456,738,232)
Humbje e vilit		(23,848,556)	38,410,669
TOTALI I KAPITALIT		537,900,032	486,210,588
Detyrimet afatgjatë			
Detyrime nga aktive të marra me qira	22	11,991,508	27,522,977
Totali i Detyrimeve Afatgjatë		11,991,508	27,522,977
Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	23	351,829,572	366,651,695
Rezerva për primet e pafituara	24	676,422,696	640,446,339
Rezerva për dëme fond kompensimi	25	4,230,533	20,519,218
Të pagueshme ndaj risigurve	26	34,987,674	34,209,202
Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe të tjera	27	98,838,661	131,209,527
Detyrime nga aktive të marra me qira	22	16,026,414	17,558,771
Detyrime për tatimin mbi fitimin		-	12,008,115
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		1,182,335,550	1,222,602,867
TOTALI I DETYRIMEVE		1,194,327,058	1,250,125,844
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,732,227,090	1,736,336,432

Këto pasqyra u miratuan nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 28 mars 2025 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Z. Edlin Ruka
Drejtor Ekzekutiv



Znj. Majlinda Trandafili
Kontabiliste

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 53 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ansig sh.a.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Prime të shkruara bruto	28	1,429,127,845	1,335,933,184
Ndryshimi neto në rezervën për primet e pafituara	24	(35,976,357)	(33,545,740)
Prime të ceduara risiguruesit	29	(69,604,703)	(57,557,971)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	24	3,496,725	5,253,979
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		1,327,043,510	1,250,083,452
Të ardhura të tjera	30	45,159,413	3,807,972
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	31	2,108,582	47,727,986
Të ardhura neto		47,267,995	51,535,958
Humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes	32	(586,259,337)	(455,294,303)
Dëme të paguara dhe ndryshim në rezervën e dëmit nga Risiguruesit		52,982,784	9,061,226
Humbje totale dhe rregullime të humbjeve		(533,276,553)	(446,233,077)
Kostot e marrjes në sigurim	33	(501,779,745)	(532,463,002)
Shpenzime administrative	34	(219,146,274)	(202,310,836)
Ndryshimi neto në rezervën për dëme Fond Kompensimi	25	16,288,685	(12,475,671)
Shpenzime të tjera të sigurimit	35	(148,594,764)	(51,051,389)
Kosto operative		(853,232,098)	(798,300,898)
Humbja nga kurset e këmbimit, neto	36	(15,018,219)	(18,263,362)
Të ardhura nga interesi	37	15,788,367	17,912,654
Shpenzime interesi		-	-
Të ardhura financiare neto		770,148	(350,708)
Fitimi para tatimit		(11,426,998)	56,734,727
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	38	(12,421,558)	(18,324,058)
Fitimi/(humbja) il(e) vitit		(23,848,556)	38,410,669
Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		(23,848,556)	38,410,669

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 53 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Ansigt sh.a.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e riskut të sigurimit	Humbje të mbartura	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2022	874,305,000	30,215,000	18,151	(456,738,232)	447,799,919
Humbja e vitit	-		-	38,410,669	38,410,669
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-		-	-	
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit, neto nga tatimi	874,305,000	30,215,000	18,151	(418,327,563)	486,210,588
Rivlerësim Aktive afatgjata materiale - Truall					
Kontributi i aksionarit në mjete monetare					
Gjendja më 31 dhjetor 2023	874,305,000	30,215,000	18,151	(418,327,563)	486,210,588
Fitimi i vitit	-	-	-	(23,848,556)	(23,848,556)
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-	
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit, neto nga tatimi	874,305,000	30,215,000	18,151	(442,176,119)	462,362,032
Pakesim i rezerves se rivlerësimit		(30,215,000)			(30,215,000)
Rivlerësim Aktive afatgjata materiale - Truall	-	-	-	-	-
Kontributi i aksionarit në mjete monetare	105,753,000	-	-	-	105,753,000
Gjendja më 31 dhjetor 2024	980,058,000	-	18,151	(442,176,119)	537,900,032

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 53 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi/(humbja) para tatimit		(11,426,998)	56,734,727
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		22,891,255	21,803,982
Të ardhurat nga interesi	37	(15,788,367)	(17,912,654)
Humbja/(fitimi) nga shitja e AGJ	35	69,988,861	4,572
Rezerva e rivleresimit		(30,215,000)	
		35,449,751	60,630,627
Ndryshimi në :			
- Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera		(53,374,659)	10,854,299
- Kostot e shtyra të marrjes në sigurim		6,465,503	13,836,435
- Llogari të arkëtueshme të risigurimit		14,668,716	8,643,884
- Aktive me të drejtë përdorimi		15,044,542	(21,686,553)
- Aktive të tjera		(57,766,900)	20,981,511
- Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve		(14,822,123)	587,218
- Rezerva për primet e pafituara		35,976,357	33,545,740
- Rezerva për dëme fond kompensimi		(16,288,685)	12,475,671
- Të pagueshme ndaj risiguresit		778,472	8,100,845
- Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe të tjera		(32,370,867)	(21,452,687)
- Detyrime nga aktive të marra me qira		(17,063,826)	19,802,264
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		(83,303,719)	146,319,254
Tatimi mbi fitimin i paguar		(25,258,620)	-
Interesi i arkëtuar		13,416,213	16,262,032
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		(95,146,126)	162,581,286
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Të hyra nga shitja e aktiveve të trupëzuara afatgjata	8	14,291,089	4,001,608
Blerje të aktiveve të trupëzuara afatgjata	8	(21,277,505)	(9,364,540)
Te hyra nga shitje e investimeve në toka dhe ndërtesa	10	180,706,138	-
Blerje e pronave për investim e investimeve në toka dhe ndërtesa	10	(105,753,000)	-
Aktive të patrupëzuara	9	(7,457,853)	(9,408,038)
Maturim i bonove të thesarit	17	46,200,000	209,360,000
Rënie/(rritje) në obligacione		2,292,000	4,140,000
Rënie/(rritje) në depozitat me afat		(118,320,091)	(359,170,291)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(9,319,222)	(160,441,261)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Rritje kapitali	20	105,753,000	-
Flukset monetare neto të (përdorura)/ gjeneruara në aktivitetet investuese		105,753,000	-
Rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		1,287,652	2,140,025
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	19	17,273,127	15,133,102
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	19	18,560,779	17,273,127

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 53 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

ANSIG INSURANCE
ANNUAL REPORT 2024

www.ansig.al

